

PËR PËRMIRËSIMIN E CILËSISË SË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË DIGJITALIZUARA NDAJ BIZNESIT

MBLEDHJE E KËSHILLIT TË INVESTIMEVE
Tiranë, 6 Tetor 2023

- I. OBJEKTI DHE METODOLOGJIA
- II. GJETJE KRYESORE
- III. REKOMANDIME

PROBLEMATIKA TË RAPORTUARA

DPD **Fiskalizimi**

(i) Problematika në fiskalizimin e doganave; (ii) ka probleme në shfaqjen e deklaratave doganore në kohe; (iii) portali i fiskalizimit shpesh nuk na lejon të fiskalizojmë praktikat doganore; (iv) Plotësimi i deklaratave doganore në self-care është dublikim i punës për çdo shoqëri që kryen importe; v) sistemi vendos gjoba automatikisht jo të drejta.

DPT **Fiskalizimi & e-tax**

i) Aplikimi për regjistrimin fillestar dhe ndryshimeve për bizneset duhen thjeshtuar; (ii) tatimet e doganat vazhdojnë të kërkojnë dokumentacione të regjistrimit apo aplikime shtesë; (iii) sistemet shpesh nuk punojnë; (iv) mungojnë njoftimet kur sistemet nuk punojnë; (v) mungon rakordimi e-tax dhe fiskalizimi.

QKB

(i) Hapja/çrregjistrimi I aktivitetit; (ii) Dorezimi i pasqyrave financiare të thjeshtohet duke hequr dublimet në raportimin e të dhënave; (iii) Procedurat e aplikimit kanë paqartësi në kërkesa; (iv) Ndryshim i vazhdueshëm i dokumentacionit të kërkuar/procedurave.

E-Albania

(i) Vonesa në përfundimin e certifikatës dhe nënshkrimi elektronik; (ii) Kthim përgjigje e pastrukturuar dhe jo shteruese ndaj biznesit; (iii) Vonesa në kthim përgjigje sidomos tek shërbimet që kanë presione kohore; (iv) Sistem i copëzuar dhe i vështirë për ankimimet ndaj institucioneve që ofrojnë shërbime; (v) Vonesa në marrjen e shërbimit.

Platforma të Bashkive

(i) Bazike; (ii) mungesë shërbimesh; (iii) nuk ofrohet asistencë për shërbimet.

ASHK

(i) Aplikimet dhe përgjigjet nga Kadastra; (ii) Shërbimet nuk janë shumë praktikë në përdorim dhe gjuha e përdorur të ishte më e kuptueshme (si dhe shembujt e paraqitur me video për aplikimet të ish-in më të kuptueshme); (iii) Mos respektim i afateve, dokumenta me gabime materiale, kthim i përgjigjes pa argumentim ligjor; vonesa në përfitim të shërbimit\.

Vizioni Politik

Agjendës Digjitale e Shqipërisë 2022–2026 - (Shërbime digjitale gjithëpërfshirëse dhe pa kufi, për qytetarët dhe bizneset)

Më specifikisht:

1. Akses i sigurt, i shpejtë dhe i besueshëm në internet
2. Një shtet digjital që ofron shërbime më të mira digjitale dhe me një nivel të lartë sigurie dhe besueshmërie
3. Zhvillimi i aftësive digjitale
4. Lehtësimi dhe mbështetja e transformimit të kompanive dhe NVM në ndërmarrje digjitale
5. Forcimi dhe përforsimi i inovacionit digjital, rritja e kapaciteteve/nivelet të sigurisë kibernetike;
6. Rritja e produktivitetit dhe sigurisë të përdorimit të të dhënave të administratës publike;
7. Përfshirja e teknologjive digjitale në të gjithë sektorët ekonomikë.

Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023–2030

Qëllimi 3 i Strategjisë:

Zgjerimi i qeverisjes digjitale në nivel vendor për të ofruar shërbime dhe programe qeveritare në mënyrë më eficiente, transparente dhe me kosto efektive – duke nënkuptuar edhe digjitalizimi i ofrimit të shërbimeve vendore dhe integrimi në portalin e-Albania.

Kombet e Bashkuara

Përsa i përket indikatorëve të TIK, Shqipëria megjithëse në shumë aspekte është mbi mesataren botërore, ka akoma një hendek jo pak të konsiderueshëm me mesataren e vendeve Evropiane. Aftësitë digjitale të popullsisë kanë nevojë të përmirësohen.

Qasja strategjike e Qeverisë ka qenë ‘agresive’ në drejtim të digjitalizimit të shërbimeve publike dhe ka krijuar një kuadër ligjor të nevojshëm për këtë zhvillim. Në “digjitalizimin e bujqësisë” - Shqipëria ka akoma shumë për të bërë. Tregtia elektronike - Shqipëria është prapa vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor

UN Albania- Albania Digital Development Country Profile 2022

Në indeksin e-Qeverisja 2022, Shqipëria ka një përkeqësim në renditje nga viti 2020, e 59 nga 193 vende në 2022 renditet në vendin e 63.

Në indeksin e e-Pjesëmarrjes, Shqipëria gjendet në një pozicion shumë më të mirë, duke u renditur e 22a në botë dhe e 10a në Europë (nga 43 vende).

Raporti i OKB për e-Qeverisjen

KE & BE

- Maturiteti i e-Qeverisjes së Shqipërisë në nivelin 46% (nga 100%), duke zënë vendin e 32 nga 37.


- Platformat e shërbimeve publike mund të vlerësohen mirë teknikisht për Shqipërinë (duke reflektuar një renditje të mirë relativisht të Shqipërisë), nga pikëpamja e vlerësimit të përdoruesve ka ende shumë punë për t’u bërë.

Raport progresi BE 2022:

“...dixhitalizimi i të dhënave kadastrale është i nevojshëm dhe sektori mbetet i prirur ndaj korrupsionit”

- “...dixhitalizimi dhe arsimimi u përmirësuan, por njohuritë sipërmarrëse dhe teknologjike mbeten të ulëta”.

Stimulimi i debatit mbi cilësinë e shërbimeve publike të digjitalizuara me fokus sektorin privat, duke evidentuar progresin dhe prioritizuar problematikat kryesore në tre shtylla:



Vlerësimi mbi barrën administrative dhe praktikat korruptive.



Eksperiencat me platformat online (e-Albania, e-taksa, e-fiskalizimi, nënshkrimi elektronik dhe platformat e bashkive).



Vlerësimi për elementë të veçantë të platformave elektronike të shërbimeve (siguria, aksesimi, afatet, navigimi, ankimimi, etj.).

Hulumtime

- Raportet, kombëtare dhe ndërkombëtare, ligje/akte nënligjore
- Analiza të të dhënave zyrtare nga burimet dytësore
- Sinteza e gjetjeve dhe rekomandimeve të deritanishme
- Puna e deritanishme e Sekretariatit mbi digjitalizimin




Konsultime

a) **Intervista gjysëm të strukturuar** me 6 institucione publike dhe komunitetin e biznesit.

b) **Konsultime (fokus grup):**

- një takim i organizuar me 15 përfaqësues të Dhomës Ekonomike të Gruas (DHEG)
- një takim i organizuar në bashkëpunim me Drejtoreshën e Qendrës Kombëtare të Biznesit me pjesëmarrjen e 25 përfaqësuesve të dhomave dhe shoqatave të biznesit dhe përfaqësuesve të AKSH-it.

c) **Diskutim i thelluar** me 8 ekspertë të pavarur të fushës, me pjesëmarrjen edhe të 2 ekspertëve nga AKSHI.



Pyetësor



Pyetësor i strukturuar (dërguar online tek 30,000 kompani) për identifikimin e sfidave kryesore në lidhje me:

- barrën administrative praktikat korruptive
- platformat online (e-Albania, e-TAX, e-fiskalizimi), nënshkrimi elektronik”, platforma të bashkive.


Anketa u plotësua nga 324 biznese në mënyrë anonime.

ANKETA E KI: PROFILI I KOMPANIVE


Mosha juaj:




Pozicioni në kompani




Madhësia e biznesit tuaj sipas xhiros së vitit të fundit



Aksioneri/Ortaku/Pronari me i madh i biznesit tuaj është:



Sektori i ekonomisë






II. GJETJE

II. BIZNESI - BARRA ADMINISTRATIVE DHE KORRUPSIONI

Biznesi i ndërgjegjësuar që shërbimet online e kanë reduktuar barrën administrative për kompaninë e tyre

Por një “barrë tjetër administrative” e brendshme e kompanisë duket se po lind, sidomos për NVM-të. Për shembull: a) Menaxhimi elektronik i dokumentave b) arkivimi, përdorimi i nënshkrimit elektronik (jo vetem në mënyrë rastësore), c) përdorimi bazik i platformave online janë sfida për SME-të.



Burimi: Anketim i Sekretariatit, Qershor 2023

Shmangia e kontaktit fizik të aplikuesve për shërbime të ndryshme publike, ka reduktuar praktikën korruptive (8 në 10 kompani)

Por ekziston perceptimi se “nëse shërbimi i kërkuar nuk jepet në kohën e duhur apo dalin pengesa” dmth ka akoma “presion të fshehur” për të gjetur një zgjidhje.




Burimi: Anketim i Sekretariatit, Qershor 2023

II. BIZNESI DHE PLATFORMAT ONLINE

Bazuar në perceptimet e biznesit vihet re që përgjithësisht bizneset janë të kënaqur me përdorimin e platformave online.

Kënaqësia me platformat e shërbimeve publike qeveritare


(vetëm ato biznese që janë përgjigjur "plotësisht i kënaqur" dhe "deri diku i kënaqur")



Burimi: Anketim i Sekretariatit, Qershor 2023

Megjithatë, pavarësisht rezultateve përgjithësisht pozitive në vlerësim të platformave online, diskutimet kualitative kanë nxjerrë në pah se kur bie fjala për shërbime specifike, të veçanta, bizneset vazhdojnë të hasin vështirësi dhe kenë pritshmëri për përmirësime (shërbime si hapja dhe mbyllja e biznesit, certifikata elektronike, rakordimi e-tax – fiskalizim, ankesat, pagesat on-line, etj.).

II. BIZNESI DHE E-ALBANIA - SFIDAT



Siguria - Mbrojtja e identitetit online konsiderohet si sfiduese bazuar në perceptimet e sektorit privat.

Mbështetja dixhitale - ose shërbimi ndaj klientit i ofruar përmes kanaleve dixhitale si email, chat, aplikacionet celulare, mediat sociale, etj., konsiderohet i pamjaftueshëm dhe cënon efikasitetin e shërbimeve digjitale.


Sistemi i ankesave - për shërbimet që merren nëpërmjet platformës duket shumë i copëzuar dhe i vështirë në përdorim për bizneset, sidomos kur vjen puna për të marrë një përgjigje të shpejtë në lidhje me shërbimet që kanë presione kohore.

Seksioni i ndihmës - është e nevojshme të pasurohet dhe të targetojë tipologjitë e ndryshme të problematikave që hasin bizneset.

Shërbimi nuk merret në kohën e caktuar - Kryesisht ato shërbime të biznesit që kanë nevojë “për përpunim” nga back-office i institucionit përgjegjës për shërbimin.

II. BIZNESI DHE KANALET E INFORMIMIT

Mungesë ndërgjegjësimi nga ana e biznesit në lidhje me kanalet e informimit ekzistuese për përfitim të shërbimeve publike




Burimi: Anketim i Sekretariatit, Mars 2023

Numri jeshil nuk njihet nga bizneset, dhe pyetja kryesore e evidentuar ishte se “pse ky numër nuk gjendet në platformën e-Albania si informacion, por vetëm në faqen e ADISA-s.

II. BIZNESI DHE PAGESAT ONLINE

Pagesat online për përfitim të shërbimeve publike digjitale konsiderohen të pazhvilluara dhe me mungesa.



Burimi: Anketim i Sekretariatit, Qershor 2023

Bizneset e anketuara megjithatë shprehin konsensus në lidhje me gadishmërinë mbi përdorimin e pagesave online ku 8 në 10 kompani janë plotësisht/deri diku të gatshme ta përdorin si opsion. Kompanitë që hezitojnë në përdorimin e këtij opsioni theksojnë kryesisht çështjen e mungesës së besimit në elementët e sigurisë të pagesave online.

II. NDËRVEPRIMI ME PUSHTETIN VENDOR

Aktualisht pushteti vendor konsiderohet i paintegruar në platformat e shërbimeve online dhe perceptimet e biznesit i konsiderojnë platformat ekzistuese lokale si bazike dhe në mungesë shërbimesh

Momentalisht të integruara në platformën e-Albania janë këto shërbime për biznesin:

- (1) E-lejet
- (2) Vetëm Bashkia e Tiranës dhe ajo e Durrësit kanë implementuar Taksa dhe Tatime Lokale në platformë po edhe kjo vetëm në nivel informimi për detyrimet
- (3) Disa bashki kanë krijuar disa platforma të tyre të copëzuara (rasti i Bashkisë Shkodër, Fier dhe Patos) që japin disa shërbime kryesisht në nivelin 1 (niveli i informimit dhe gjenerimit të faturës me detyrime).

Janë një sërë shërbimesh në nivel vendor që biznesi i konsideron me barrë administrative (që kërkojnë aplikime dhe dokumenta që mund të eliminoreshin në kuadër të një derregullimi apo ri-inxhinierimi) të tilla si:

- (1) Regjistrimi dhe ç'regjistrimi i biznesit për efekt të taksave dhe tarifave vendore
- (2) Pagesa e Tatim-Taksave vendore
- (3) Lejet bashkiake të kërkuara për aktivitetin normal të biznesit deri në 500 kë për instalimin e njësive gjeneruese të prodhimit të energjisë elektrike nga era ose dielli nga një shoqëri e vogël ose e mesme apo një klient familjar, nga më të lartat në rajon (ku varion zakonisht deri në 200 kë).

II. OPTIMIZIMI I NDËRVEPRIMIT INSTITUCIONAL

Ndërlidhja e regjistrave të Qendrës Kombëtare të Biznesit me regjistrat e institucioneve të tjera publike do të lehtësonte përftimin e shërbimeve publike duke minimizuar dublikimet e dokumentave të kërkuara

Shërbimet e ofruara nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës nëpërmjet platformës e-Albania janë më problematike për biznesin.

Problematikat e evidentuara përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në:

- (a) moskthimin e përgjigjeve për aplikimet e bëra sipas kartelave të informacionit dhe afateve ligjore në e-Albania
- (b) kthimin e përgjigjeve të paqarta dhe me referenca ligjore konfuze
- (c) kërkesave për plotësimin e dokumentave shtesë të cilat disponohen ose janë lëshuar më parë nga vetë Kadastra ose që mund të merren nga institucionet e tjera
- (d) moskonfirmimin e kopjeve të kartelave të pronësisë zyraive noteriale sipas afateve ligjore duke penguar transaksionet e pronësisë dhe ato bankare.

II. BIZNESI - RIINXHINIERIMI DHE DERREGULLIMI

Nga analiza e kuadrit ligjor dhe e kompetencave të institucioneve përgjegjëse për digjitalizimin, rezulton se funksionet e ri-inxhinierimit/derregullimit janë të decentralizuara dhe të shpërndara në disa ligje dhe midis disa institucioneve. Kjo krijon mbivendosje të kompetencave, paqartësi në llogaridhënie dhe në drejtimin e këtij funksioni

AKSHI është përgjegjës për riinxhinierimin elektronik të shërbimeve publike duke u vënë në lëvizje për këtë qëllim nga institucioni përkatës. Kjo kompetencë i jepet sipas nenit 29/f të ligjit nr. 43/2023 “Për Qeverisjen Elektronike”.

ADISA ka kompetenca për të iniciuar riinxhinierimin e shërbimeve publike. Sipas përcaktimeve të nenit 13 të ligjit nr. 13/2016 “Për Mënyrën e Ofrimit të Shërbimeve Publike në Sportel në Republikën e Shqipërisë”.

Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje i është shtuar arkitekturës së institucioneve të përfshira në riinxhinierimin/derregullimin e shërbimeve publike, sipas parashikimeve të ligjit nr 107/2021 “Për Bashkëqeverisjen”.

Ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes – Nga analiza e kuadrit ligjor dhe e kompetencave si edhe nga raportet publike, nuk evidentohet cili është roli i saj në procesin e ri-inxhinierimit dhe derregullimit të shërbimeve ndaj biznesit.



REKOMANDIME

Rekomandimi 1. Institucionalizimi i procesit të rinxhinierimit dhe derregullimit dinamik të shërbimeve publike administrative të ofruara nga institucionet qendrore për Biznesin.

- **PËRGJEGJËSIA INSTITUCIONALE** - Do të ishte e rekomandueshme, edhe nga pikëpamja ligjore, një qasje e integruar përmes një strukture që të kishte në vëmendje në **mënyrë të vazhdueshme** përmirësimin e shërbimeve duke propozuar dhe ndjekur zbatimin e propozimeve për përmirësimin e shërbimeve. Kështu do të shmangeshin ndërrhyrjet ad-hoc dhe jo të integruara.

REKOMANDIME

– RIINXHINIERIMI DHE DERREGULLIMI NË NIVEL VENDOR

Rekomandimi 2. Digjitalizimi i shërbimeve publike administrative vendore për biznesin.

- **(1) Qartësimi ligjor dhe institucional për koordinimin dhe implementimin e procesit të digjitalizimit të shërbimeve vendore.** Kjo do të kërkonte bashkëpunimin midis agjencive në nivel qendror (AKSHI, Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje, Agjencia për mbështetjen e vetëqeverisjes vendore, QKB) dhe bashkive (në nivel shoqatash) për të krijuar një mekanizëm koordinues.
- **(2) Një proces harmonizimi, kategorizimi, kodifikimi dhe rinxhinerimi të shërbimeve vendore të identifikuara në nivel vendor.**

REKOMANDIME

– EDUKIM DHE NDËRGJEGJËSIM

Rekomandimi 3. Mbështetje për “digjitalizim” dhe edukim/aftësim digjital të bizneseve sidomos me fokus NVM/gratë.

- Kjo rekomandohet përmes:
 - (a) Programeve me grante/asistencë për NVM-të
 - (b) Edukimit Digjital përmes fushatave masive ndërgjegjësuere të vazhdueshme psh. “Dita shqiptare e dixhitalizimit”.
 - (c) Programeve të trajnimit të ofruara për biznesin për të lehtësuar përdorueshmërinë dhe adoptimin me tranzicionin digjital si p.sh. përdorimi i e-albania, menaxhimi i dokumentave elektronike, përdorimi i nënshkrimit elektronik, sistemet e menaxhimit të informacionit, etj.
 - (d) Tutoriale të dedikuara për çdo shërbim.

REKOMANDIME

– AFTËSIM DIGJITAL I ADMINISTRATËS

Rekomandimi 4. Rritja e cilësisë së shërbimit ndaj biznesit, si një nga taksapaguesit kryesor të buxhetit kushtëzohet jo vetëm nga niveli i investimeve në kapacitete teknike/teknologji apo lehtësimi i procedurave përkatëse, por edhe nga cilësia e aftësimin digjital të stafit të administratës publike.

- Sugjerohet:

- (1) hartimi dhe publikimi vjetor i nje roadmap me qartësim të detyrave dhe buxheteve të trajnimit
- (2) rritja e kapaciteteve përmes trajnimit të vazhdueshëm të administratës mbi ndryshimet digjitale
- (3) monitorimi transparent i rezultateve për hir të arritjes së objektivave të reformës, kostove buxhetore dhe cilësisë së llogaridhënies ndaj taksapaguesve.

REKOMANDIME

– SIGURIA DIGJITALE

Rekomandimi 5. Referuar sigurisë së informacionit të shkëmbyer në platformat digjitale ku ofrohen shërbime administrative.

- Sugjerohet:
 - (1) të krijohet një *“back up plan”* në rast sulmesh kibernetike dhe të bëhet transparent për bizneset e publikun e gjerë që të nxitet e rritet besimi në platforma
 - (2) të mundësohet klasifikimi i informacionit që bëhet publik, pra të dhënat e deklaruara nga bizneset të jenë me akses të limituar (p.sh. me pagesë).

REKOMANDIME

– ASISTENCA

Rekomandimi 6. Lehtësimi i përdorueshmërisë së platformave nga bizneset, nëpërmjet unifikimit të procesit të asistencës përmes një sistemi të integruar suporti.

Për të krijuar një sistem të integruar të bazuar në eksperiencën e përdoruesit, e rëndësishme do ishte:

- hartëzimi në mënyrë të detajuar dhe përcaktimi i niveleve/“pikave të kontaktit” (*touchpoints*) që duhet të prekë përdoruesi për të marrë përgjigjet në mënyrë sa më efçente.
- të unifikohet një numër telefoni suporti dhe të jepet mundësia e “chat bot” në kohë reale mbi problematikat në shërbime.

REKOMANDIME

– ANKESAT

Rekomandimi 7. Thjeshtimi i procesit të ankesave nëpërmjet harmonizimit, integritit dhe përmirësimit të sistemit të ankesave për shërbimet administrative.

- Hartëzimi i “udhëtimit të përdoruesit’ për çështjen “Kam një ankesë për shërbimin” që duhet të përcaktojë të gjitha nivelet e kontaktit dhe të integrojë rrugën që duhet të ndjekë përdoruesi. Ky hartëzim duhet të shërbejë si baza e “digjitalizimit” brenda platformës e-Albania (e lidhur me shërbimin specifik të kërkuar) të ankesës dhe efikasitetin e zgjidhjes së ankesave në përgjithësi.
- Përparësore për biznesin vlerësohen “ankesat” që kanë të bëjnë me marrjen e shërbimeve nga (1) QKB, (2) Doganat, (3) Administrata Tatimore.

REKOMANDIME

– PAGESAT ONLINE

Rekomandimi 9. Përmirësimi i sistemit të pagesave online për shërbime administrative qendrore.

Nga komuniteti i biznesit është shprehur gatishmëri për të operuar me pagesat online (përtej skepticizmit mbi sigurinë e transaksioneve), ndaj rekomandohet që në e-Albania të mundësohen pagesat online përmes të gjitha bankave të nivelit të dytë apo edhe opsioneve të tjera të pagesave duke lejuar diversifikim, lehtësim dhe përshpejtim të shërbimeve për bizneset.

REKOMANDIME

– TEKNIKALITETE

Rekomandimi 8. Rishikimi, vlerësimi dhe rregullimi i shërbimeve administrative për biznesin bujqësor dhe fermerët në drejtim të:

(1) Regjistrimit fillestar të shoqërive për bashkëpunim bujqësor pasi i gjithë procesi i regjistrimit të këtyre shoqërive dhe kërkesave dokumentare duhet rishikuar meqënëse momentalisht konsiderohet i vështirë dhe subjekt intepretimesh të paqarta, (2) Rregullimit të regjistrimit të fermerëve me NIPT duke qenë se të gjithë fermerët të cilët shesin prodhimet e tyre tek sipërmarrësit (tregtarë), janë të detyruar të regjistrohen dhe të pajisen me certifikatën e NIPT-it. Do të ishte e rekomandueshme që kjo procedure të unifikohej dhe fermerët të operonin me një NIPT të vetëm.

Rekomandim 10. Thjeshtim i ndërveprimit dhe përdorueshmërisë së platformave për bizneset, përmes:

(1) Selektimit/shfaqjes të shërbimeve që ofrohen vetëm për bizneset në e-Albania që në momentin e hyrjes në platformë (jo të gjitha shërbimet që përfshijnë edhe ato për qytetarët individ siç është momentalisht), (2) mundësimin të gjurmueshmërisë së proceseve sidomos në rastet e bllokimit të platformës, (3) sistemit të Fiskalizimit ku të mundësohet kodifikimi i NIVF-ve sipas një rendi logjik (jo numër pa lidhje), (4) mundësimin të shkarkimit të faturave njëherazi në bazë javore/ mujore në mënyrë automatike nga sistemi i fiskalizimit, gjë që do lehtësonte arkivimin nga ana e bizneseve.



DISKUTIME

A JEMI GATI?

Perceptimet e biznesit në lidhje me nivelin e sigurisë së të dhënave, mbështetjes në lehtësimin e përdorimit të platformave, kanaleve të ankimimit, apo nivelit të saktësisë së përgjigjeve nga institucionet mbeten sfiduese.

Gjithashtu, edhe në vijim të vlerësimeve publike, problematike mbeten qëndrueshmëria institucionale dhe koordinimi, aftësimi dixhital i stafit të administratës dhe edukim në vazhdimësi.

A ka ardhur koha që sipërmarrësit të kthejnë sytë drejt përthithjes së digjitalizimit si një mekanizëm për integrimin ekonomik, pasi është tashmë e provuar lidhja direkte midis tij dhe rritjes së produktivitetit të ndërmarrjeve dhe konkurrueshmërisë?

Digjitalizimi nuk duhet të konsiderohet qëllim në vetvete, por një mekanizëm për të përmirësuar performancën e administratës publike në ofrimin e shërbimeve publike me kosto optimale.

FALEMINDERIT!
www.investment.com.al